


Analizë e titujve të themeluara në bazë gjinore:



# Barazia gjinore

në kohën e  
*dezinformatave gjinore*

Analizë e titujve të themeluara në bazë gjinore:

# **Barazia gjinore**

në kohën e  
*dezinformatave gjinore*

**Publikues:**

Instituti për studime komunikative  
Rr. „Jurij Gagarin“ 17-1-1, Shkup  
www.iks.edu.mk

**Për publikuesin:**

prof. i çregull. D-r Zhaneta Trajkoska

**Edicioni:**

ResPublica

**Autorë:**

m-r Bojana Jovanovska  
m-r Jovana Jovanovska

**Redaktor:**

m-r Dejan Andonov

**Përkthim nga gjuha maqedonase:**

Vjosa Taipi

**Titulli origjinal:**

Анализа на родово-базирани содржини:  
Родовата еднаквост во време на родови  
дезинформации

**Dizajni grafik:**

Igor Delov

**Vendi dhe viti:**

Shkupi, 2023

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

305:316.776.23(497.7)"2023"(047.31)  
316.774:004.738.5(497.7)"2023"(047.31)

JOVANOVSKA, Bojana

Analizë e titujve të themeluara në bazë gjinore [Електронски извор]  
: barazia gjinore në kohën e dezinformatave gjinore / [autorë Bojana  
Jovanovska, Jovana Jovanovska ; përkthim nga gjuha maqedonase Vjosa  
Taipi]. - Shkup : Instituti për studime komunikative, 2023. - (Edicioni  
ResPublica)

Начин на пристапување (URL):

<https://respublica.edu.mk/wp-content/uploads/2023/10/rodovata-ednakvost-vo-vreme-na-rodovi-dezinformacii.pdf>

(Слободен пристап). - Превод на делото: Анализа на родово-базирани  
содржини : родовата еднаквост во време на родови дезинформации. - Текст  
во PDF формат, содржи 40 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. -  
Опис на изворот на ден 19.10.2023. - Фусноти кон текстот. - "Përdorim i  
gazetarisë të themeluar ne fakte për ngritjen e vetëdijes dhe  
kundërshtimit të dezinformacioneve në hapësirat mediatike në Maqedoninë  
e Veriut "

ISBN 978-608-4805-36-6

1. Jovanovska, Jovana [автор]

а) Родови дезинформации -- Онлајн медиуми -- Македонија -- 2023 --  
Истражувања

COBISS.MK-ID 62023685

# Hyrje

Dezinformatat mund të përkufizohen si informacion i rremë i krijuar qëllimisht për të dëmtuar një person, grup shoqëror ose organizatë të caktuar, ku natyra e rreme e informacionit mund të rezultojë gjithashtu nga të ashtuquajturat “informacione të manipuluar”.<sup>1</sup> Kështu, dezinformatat gjinore i referohet çdo informacioni të rremë dhe të manipuluar që synon të shkaktojë dëm për gratë ose njerëzit e gjinive dhe seksualiteteve të ndryshme. Një nga përkufizimet fillestare të dezinformimit gjinor përfshin përhapjen e informacionit dhe imazheve mashtruese ose të pasakta kundër udhëheqësve politikë, gazetarëve dhe figurave publike femra, duke ndjekur narrativet e bazuara në mizogjininë dhe rolet gjinore stereotipike.<sup>2</sup> Megjithatë, përpos asaj që përhapja e dezinformatave gjinore po merr një hov gjithnjë e më të madh, duke pasur parasysh kompleksitetin e tyre, vetë koncepti është ende në fazën e ndërtimit, prandaj njohja dhe adresimi i tyre përkatës ende është një sfidë e madhe.

Dezinformimi gjinor i referohet aktiviteteve (krijimi, ndarja, shpërndarja e përmbajtjeve) që sulmojnë ose minojnë reputacionin e njerëzve në bazë të gjinisë së tyre dhe keqpërdorin stereotipet gjinore për të promovuar qëllimet politike, sociale ose ekonomike.<sup>3</sup> Një nga mënyrat më të thjeshta për të njohur komponentin gjinor të dezinformatave është se dezinformatat janë gjinore nëse synojnë gratë bazuar në identitetin e tyre si grua.<sup>4</sup> Shembujt më të zakonshëm të dezinformatave gjinore janë përmbajtja e rreme, fushatat e koordinuara për të krijuar dhe ndarë dezinformata që nënvlerësojnë karakterin e grave, karikaturizimi dhe demonizimi i mbështetësve të barazisë gjinore.<sup>5</sup> Fushatat për dezinformim gjinor kryesisht

1 Internet Governance Forum. (2021). *Best Practice Forum Gender and Digital Rights: Exploring the concept of Gendered Disinformation. OUTPUT DOCUMENT*. Në dispozicion në: [https://www.intgovforum.org/en/filedepot\\_download/62/20661](https://www.intgovforum.org/en/filedepot_download/62/20661)

2 Ibid.

3 Judson, E. et al. (2020). *Engendering Hate: The Contours of State-Aligned Gendered Disinformation Online. Demos*. Në dispozicion në: <https://demos.co.uk/wp-content/uploads/2020/10/Engendering-Hate-Report-FINAL.pdf>

4 Blatnik, A. (2021). *An overlooked Threat to Democracy? Gendered Disinformation About Female Politicians*.

5 Internet Governance Forum. (2021). *Best Practice Forum on Gender and Digital Rights: Exploring the concept of gendered disinformation*. Në dispozicion në: [https://intgovforum.org/en/filedepot\\_download/248/21181](https://intgovforum.org/en/filedepot_download/248/21181)

synojnë njerëzit me një status të caktuar publik ose pozicione të tilla si politikanë, gazetarë, aktivistë, artistë, etj.

Mediat online dhe platformat e mediave sociale janë burimi kryesor i dezinformatave, gjuhës së urrejtjes dhe shkeljeve të standardeve profesionale<sup>6</sup>, duke i bërë mediat sociale mjetin kryesor për përhapjen e dezinformatave gjinore në kontekstin kombëtar. Mediat sociale mund të formësojnë qëndrimet në lidhje me aftësitë politike të grave dhe rëndësinë e përfaqësimit të grave, ku<sup>7</sup> përforcimi i stereotipeve negative gjinore në hapësirën online do të ndikojë në përforcimin e qëndrimeve misogyniste në lidhje me rolin e grave në sferën publike dhe në shoqëri.<sup>8</sup> Në këtë kontekst, është thelbësore të identifikohen dhe të kuptohen dezinformatat gjinore, por edhe të trajtohen dhe adresohen si një problem për institucionet demokratike, duke pasur parasysh pasojat negative që mund të kenë mbi barazinë gjinore dhe zhvillimin e një shoqërie në përgjithësi. Prandaj, me këtë analizë, përpiqemi të kontribuojmë në ekspozimin e dezinformatave që janë shpërndarë në raportet gazetareske në muajt e fundit, si dhe efektet që ato kanë në krijimin dhe ndarjen e dezinformatave gjinore dhe gjuhës së urrejtjes me bazë gjinore, veçanërisht ndaj grave.

Kjo analizë, e titulluar “Barazia gjinore në kohën e dezinformatave gjinore”, është analiza e dytë e përmbajtjeve me bazë gjinore e përgatitur nga Instituti për Studime të Komunikimit në kuadër të projektit “Përdorimi i gazetarisë së bazuar në fakte për rritjen e ndërgjegjësimit dhe për kundërshtimin e dezinformatave në hapësirën mediatike në Maqedoninë e Veriut”, i cili zbatohet me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup.

6 European Commission. (2022). *North Macedonia 2022 Report*. Në dispozicion në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/North%20Macedonia%20Report%202022.pdf>

7 Di Meco, L. (2020). *Online Threats to Women's Political Participation and The Need for a Multi-Stakeholder, Cohesive Approach to Address Them*. UN Women. Në dispozicion në: [https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/CSW/65/EGM/Di%20Meco\\_Online%20Threats\\_EP8\\_EGMCSW65.pdf](https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/CSW/65/EGM/Di%20Meco_Online%20Threats_EP8_EGMCSW65.pdf)

8 Judson, E. (2021). *Gendered disinformation: 6 reasons why liberal democracies need to respond to this threat*. Heinrich-Böll-Stiftung. Në dispozicion në: [https://eu.boell.org/en/2021/07/09/gendered-disinformation-6-reasons-why-liberal-democracies-need-respond-threat#\\_ftn1](https://eu.boell.org/en/2021/07/09/gendered-disinformation-6-reasons-why-liberal-democracies-need-respond-threat#_ftn1)

# Metodologjia

Qëllimi i kësaj analize është të identifikojë dezinformatat në lidhje me propozim-ligjin për barazinë gjinore dhe ndryshimet në Ligjin për evidencën amzë, në korrelacion me dezinformatat gjinore që ishte produkti i tyre i drejtpërdrejtë. Kështu, analiza mbulon përmbajtje me bazë gjinore që synon të krijojë, përmes përdorimit të stereotipeve gjinore, përmbajtje të bazuar në të pavërteta, fyerje, seksualizim, denigrim dhe tallje të grave, me qëllim që t'i heshtë, përkatësisht t'i përjashtojë ato nga diskursi publik. Analiza do të kontribuojë në njohjen dhe kuptimin më të mirë të dezinformatave gjinore, si dhe diskreditimin e zërit femëror në hapësirën online, kryesisht duke përjetësuar stereotipet gjinore.

Për këtë qëllim, duke analizuar raportet gazetareske të publikuara në mediat online, analiza mbuloi përpunimin e një studimi rasti, duke përdorur analizë cilësore të përmbajtjes së botuar në periudhën nga maji deri në korrik 2023, e cila mbulon ngjarjet që lidhen drejtpërdrejt me temën e analizës, përkatësisht Paradën e Krenarisë (Skopje Prajd 2023) dhe protestën e organizuar nga Kisha Ortodokse Maqedonase (KOM), që u mbajt në qershor. Për qëllimet e kësaj analize, u analizua një mostër prej më shumë se 1,000 raporte gazetareske të publikuara në mediat online dhe më shumë se 7,000 komente mbi publikimet mbi raportet gazetareske në mediat sociale, përkatësisht në platformën Facebook.

Përmbajtja me bazë gjinore u analizua përmes disa aspekteve specifike:

- Përdorimi i dezinformatave (gjinore) në lidhje me rregulloret dhe politikat ligjore
- Përdorimi i gjuhës sensacionaliste
- Përdorimi i gjuhës seksiste dhe gjuhës së urrejtjes
- Përdorimi i stereotipeve gjinore
- Roli i medias në parandalimin dhe promovimin e dezinformatave (gjinore)

Në kuadër të kësaj analize, u përdorën identitetet e disa politikanëve femra që mbajnë poste publike, ndërsa pjesa tjetër e grave tregohet përmes profesioneve të tyre. Asnjë përmbajtje që përshkruan dhunë të qartë nuk u transmetua në analizë.

# Konteksti i analizës

Dezinformatat gjinore funksionojnë në mënyrë të tillë që duke përdorur dhe theksuar stereotipet gjinore, krijuesit përpiqen të bindin audiencën se gratë janë budallaqe, seksuale, imorale, tinëzare, të dobëta, të pambrojtura dhe qëllimi kryesor i të cilave është të tregojnë se vendi i grave nuk është në sferën publike, domethënë të përjashtojnë gratë nga diskursi publik dhe qendrat e mundshme të pushtetit. Dezinformimi gjinor është një mjet për të shqetësuar gratë, i cili mund të ndikojë në vetë-censurimin dhe të kontribuojë në përfaqësimin e tyre më të vogël në sferën publike, gjë që u dërgon mesazh të gjitha grave për vendin dhe rolin e tyre në shoqëri.

Përhapja e këtij lloji të dezinformatave në Maqedoninë e Veriut mund t'i atribuohet veprimeve të subjekteve që lidhen me lëvizjen kundër gjinisë, e cila është në rritje.<sup>9</sup> Përveç kësaj, lëvizjet kundër gjinisë përdorin narrativë të bazuar në mizogjininë, homofobinë dhe transfobinë, të cilat në fakt janë karakteristika të zakonshme të dezinformimit gjinor.

Lëvizjet kundër gjinisë përfaqësojnë një lëvizje ndërkombëtare ose transnacionale që kundërshton atë që ata e quajnë “ideologji gjinore” ose “teori gjinore”, me një përkufizim të lëvizjeve kundër gjinisë duke qenë se përfaqësojnë një formë të organizuar veprimi që bashkon aktorë të ndryshëm kundër asaj që përkufizohet si “ideologji gjinore”.<sup>10</sup> Ajo që është e rëndësishme të theksohet është se lëvizjet kundër gjinisë janë në thelb jodemokratike dhe përbëjnë një kërcënim për të drejtat e njeriut, veçanërisht të drejtat e grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara në shoqëri dhe kanë tendencë të ndikojnë në mënyrë regresive në zhvillimin e deritanishëm në drejtim të gjithë-përfshirjes dhe barazisë.

9 Kotevska, B. et al. (2023). *Franet National contribution to the Fundamental Rights Report 2023 North Macedonia*. FRA. Në dispozicion në: [https://epi.org.mk/wp-content/uploads/frr\\_2023\\_north\\_macedonia\\_en.pdf](https://epi.org.mk/wp-content/uploads/frr_2023_north_macedonia_en.pdf)

10 Veliçkovska, M. dhe Cvetković, I. (2022). *Kush ka frikë nga gjinia? Analiza e strategjive dhe narrativave kryesore të lëvizjeve kundër gjinisë në Maqedoninë e Veriut*. Koalicioni MARGIJNI Shkup. Në dispozicion në: [http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2022/10/koj-se-plashi-od-rodot\\_-interactive.pdf](http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2022/10/koj-se-plashi-od-rodot_-interactive.pdf)



Lëvizjet e ndërmarra nga qytetarët në Maqedoninë e Veriut u intensifikuan drejt fundit të vitit 2020, të nxitura nga reformat e parashikuara nga Koncepti i ri i Arsimit Fillor. Në kuadër të diskutimeve publike mbi Konceptin, disa grupe avokuan kundër arsimit të ndjeshëm gjinor dhe pilotimit të edukimit seksual, duke përdorur terma të tillë si “ideologjia gjinore” dhe “indoktrinimi gjinor” si një pikë mobilizimi në kontekstin lokal.<sup>11</sup> Ndërkohë, narrativet kryesore rreth të cilave bëhet mobilizimi i këtyre grupeve janë “mbrojtja e fëmijëve”, “ruajtja e familjes”, “biologjia/natyra/normalja”. Shumica e këtyre grupeve dhe individëve vazhduan aktivitetet e tyre në vitet e ardhshme, duke avokuar kundër ndryshimeve në ligje dhe politika të caktuara, përfshirë propozim - ligjin e ri për barazinë gjinore dhe ndryshimet në Ligjin për evidencën amzë.

Një nga “viktimat” e ndikimit të lëvizjeve kundër gjinisë ishin pikërisht ndryshimet e propozuara në Ligjin për evidencën amzë që në vitin 2020. Gjegjësisht, në vitin 2019, në rastin *X vs Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) konstatoi se Maqedonia e Veriut shkel Konventën për të Drejtat e Njeriut sepse korniza aktuale ligjore në vend nuk siguron procedura të shpejta, transparente dhe të arritshme për ndryshimin e gjinisë së regjistruar të personave transgjinorë në certifikatat e lindjes.<sup>12</sup> Me njohjen ligjore të gjinisë, personat do të mund të ndryshojnë indikatorin gjinor në evidencën amë, në mënyrë që të jenë në përputhje me identitetin e tyre gjinor dhe pamjen fizike. Në këtë mënyrë, duke harmonizuar dokumentet personale të identifikimit që do të pasqyrojnë identitetin përkatës gjinor, personat do të jenë në gjendje të mbrohen nga një sërë shkeljesh dhe diskriminimi të të drejtave të njeriut, përfshirë gjatë punësimit, shëndetësisë, etj., si dhe nga sulmet fizike dhe verbale.<sup>13</sup> Megjithëse ligji aktual nuk ndalon ndryshimin e përcaktimit të gjinisë në evidencën amë, dhe disa nga personat transgjinorë e kanë bërë tashmë ndryshimin, megjithatë mbetet ende në vullnetin e institucioneve, domethënë ende nuk ka një procedurë të qartë që mund të zgjasë me vite. Zbatimi i plotë i aktgjykimit të GJEDNJ-së përfshin miratimin e një kuadri ligjor që do të garantojë procedurë të përshtatshme ligjore për njohjen gjinore bazuar në vetë-përcaktim, me paraqitjen e kërkesës tek noteri publik, për qëllimin e të cilit Ministria e Drejtësisë krijoi grup pune të përbërë nga përfaqësues të të gjitha institucioneve përkatëse, si dhe organizatave të shoqërisë

11 Ibid.

12 ECHR, *X vs The former Yugoslav Republic of Macedonia*, Апликација бр. 29683/16, 17 janar 2019.

13 Boshkova, N. dhe Raiden, I. (2017). *Analiza e praktikave pozitive për njohjen ligjore të gjinisë*. Në dispozicion në: [https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/kszpmz\\_Analiza-na-pozitivni-praktiki\\_a4\\_pregled-3\\_0.pdf](https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/kszpmz_Analiza-na-pozitivni-praktiki_a4_pregled-3_0.pdf)

civile që punojnë në këtë fushë. Grupi i punës punoi për dy vjet për hartimin e ndryshimeve në Ligjin për evidencën amzë, duke përfshirë rregullimin e procedurës ligjore për njohjen gjinore, ndryshimet e të cilave u dorëzuan në Kuvend. Megjithatë, vetëm një ditë para se të diskutohej propozimi, pa asnjë konsultim publik, Qeveria e tërhoqi ligjin nga procedura parlamentare, si rezultat i drejtpërdrejtë i aktiviteteve të vazhdueshme të avokimit të disa grupeve kundër gjinore. Mobilizimi kundër ligjit rezultoi në formimin e “Koalicionit për mbrojtjen e fëmijëve”, i cili përfshin 26 subjekte, shumica e të cilave janë shoqata të qytetarëve dhe grupeve informale, por edhe parti politike dhe grupe fetare, të cilat, përmes përdorimit të lajmeve të rreme, manipulimeve dhe panikut moral, me qëllim shkaktimin e paranojës dhe frikës tek popullata dhe vendimmarrësit, e kthyen çështjen e njohjes ligjore gjinore në një çështje të mbrojtjes së grave dhe fëmijëve, një paralajmërim për agjendat e fshehura të aktivistëve LGBTI-së për të shkatërruar shoqërinë dhe shtetin, si dhe teori të ndryshme konspirative.<sup>14</sup> Pikërisht këto ndryshime kanë qenë subjekt i kritikave nga KOM-ja, si dhe nga organizatat dhe shoqatat e lartpërmendura që janë pjesë e lëvizjes kundër gjinisë, si dhe komuniteteve të tjera fetare, në periudhën që po shqyrtohet në këtë analizë.

Megjithatë, një “viktimë” e mundshme e lëvizjeve kundër gjinisë është bërë edhe propozim-ligji për barazinë gjinore, i cili duhet të zëvendësojë Ligjin për mundësi të barabarta të burrave dhe grave, i miratuar për herë të parë në vitin 2012. Nevoja për të miratuar një ligj të ri lindi nga efektiviteti i kufizuar i ligjit dhe nevoja për të forcuar kapacitetet (financiare dhe njerëzore) të makinerisë gjinore, përkatësisht mekanizmat institucionalë për barazinë gjinore, si organe të mandatuara për promovimin e barazisë gjinore dhe për mbështetje të integritit të barazisë gjinore në politikat e përgjithshme në të gjitha fushat.<sup>15</sup> Këto organe më së shpeshti përbëhen nga një organ i qeverisjes qendrore, përkatësisht Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, e plotësuar nga një strukturë ndërministrorë për koordinimin e integritit gjinor dhe personat e kontaktit ose pikat e kontaktit përgjegjës në secilën ministri kompetente për zbatimin e integritit gjinor në politikat përkatëse. Mangësitë e identifikuara ishin pjesë e rekomandimeve të Komitetit për Eliminimin

14 Veliçkovska, M. dhe Cvetković, I. (2022). *Kush ka frikë nga gjinia? Analiza e strategjive dhe narrativave kryesore të lëvizjeve kundër gjinisë në Maqedoninë e Veriut*. Koalicioni MARGIJNI Shkup. Në dispozicion në: [http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2022/10/koj-se-plashi-od-rodot\\_-interactive.pdf](http://coalition.org.mk/wp-content/uploads/2022/10/koj-se-plashi-od-rodot_-interactive.pdf)

15 Detyrimi për të krijuar një mekanizëm institucional efikas dhe efektiv buron nga Deklarata e Pekinit e vitit 1995, nënshkruese e së cilës është Maqedonia e Veriut.

e Diskriminimit ndaj Grave në Kombet e Bashkuara,<sup>16</sup> pasuar nga analizat e zbatimit të ligjit në nivel lokal dhe qendror në vitin 2019, me qëllim<sup>17</sup> krijimin e një grupi pune në vitin 2020 që përfshin përfaqësues të të gjitha institucioneve përkatëse, organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertëve të tjerë me përvojë shumëvjeçare në këtë fushë. Teksti i propozim-ligjit të ri i është dorëzuar edhe Komisionit të Venecias.<sup>18</sup> Pas dy vitesh punë, ligji ishte në fazën përfundimtare dhe teksti u diskutua në disa debate publike të organizuara nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS). Ndërkohë, sipas informacionit, zgjidhja ligjore e propozuar nuk gjen asnjë vërejtje thelbësore nga ana e asnjë partie politike.

Politikat dhe angazhimet për barazinë gjinore të Maqedonisë së Veriut datojnë edhe para se termi “barazi gjinore” të bëhej pjesë e legjislacionit. Strategjia e parë për Barazi Gjinore 2013-2020<sup>19</sup> u miratua në vitin 2013 në bazë të nenit 9 paragrafi 3 të Ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, ndërsa në vitin 2022 u miratua Strategjia aktuale për periudhën 2022-2027.<sup>20</sup> Përkundër kësaj, lëvizjet kundër konceptit të gjinisë kanë filluar të përhapin dezinformata për vendosjen e termit “barazi gjinore” pikërisht përmes zgjidhjes së re ligjore. Për më tepër, retorika e tyre nga termi “barazi gjinore” abstraktohet fjala “gjini”, e cila është subjekt mbi bazën e të cilit kryhet manipulim i mëtejshëm, veçanërisht përmes instalimit të supozuar të termit “identitet gjinor” me zgjidhjet e reja ligjore. Megjithatë, edhe termi «identitet gjinor» u prezantua shumë më herët në legjislacionin maqedonas, kështu që, për shembull, për disa vjet ka qenë një nga bazat diskriminuese të rregulluara me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga

16 CEDAW. (2018). *Concluding observations on the sixth periodic report of the former Yugoslav Republic of Macedonia*. Në dispozicion në: [https://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2FC%2FMKD%2FCO%2F6&Lang=en](https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2FC%2FMKD%2FCO%2F6&Lang=en)

17 Në dispozicion në: [https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/dokumenti/2020/5.3\\_Assessment%20of%20the%20Law%20on%20EOWM\\_CENTRAL%20LEVEL\\_FINAL\\_MKD.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/dokumenti/2020/5.3_Assessment%20of%20the%20Law%20on%20EOWM_CENTRAL%20LEVEL_FINAL_MKD.pdf) и [https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/dokumenti/2020/5.3\\_Assessment%20of%20the%20Law%20on%20EOWM\\_LOCAL%20LEVEL\\_FINAL\\_MKD.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/dokumenti/2020/5.3_Assessment%20of%20the%20Law%20on%20EOWM_LOCAL%20LEVEL_FINAL_MKD.pdf)

18 Në dispozicion në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-REF\(2021\)044-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-REF(2021)044-e)

19 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 6/12. Në dispozicion në: <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/9d01686c914343d28b15b2605b82272b.pdf> <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/9d01686c914343d28b15b2605b82272b.pdf>

20 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 170/22. Në dispozicion në: <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/9d01686c914343d28b15b2605b82272b.pdf> [https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/strategjia\\_/D0%A1%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%B8%D1%98%D0%B0\\_%D0%B7%D0%B0\\_%D1%80%D0%BE%D0%B4%D0%BE%D0%B2%D0%B0\\_%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82\\_2022\\_2027.pdf](https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/strategjia_/D0%A1%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%B8%D1%98%D0%B0_%D0%B7%D0%B0_%D1%80%D0%BE%D0%B4%D0%BE%D0%B2%D0%B0_%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82_2022_2027.pdf)

diskriminimi.<sup>21</sup> Gjithashtu, në Propozim-ligjin për barazi gjinore nuk përmendet fare njohja ligjore e “identitetit gjinor”, por vetëm në Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për evidencën amzë, megjithatë, të dyja zgjidhjet ligjore vendosen në të njëjtën paketë dhe etiketohen si të rrezikshme për rendin shoqëror, duke u udhëhequr ekskluzivisht nga perceptimet tradicionalisht patriarkale të atij rendi.

Edhe pse deklaratat e klerikëve kundër ligjeve, por edhe kundër barazisë gjinore në përgjithësi, filluan të rriten më shumë që në mars, retorika kundër konceptit gjinor u intensifikua pak para Paradës së Krenarisë, duke rezultuar në organizimin e një proteste nga KOM kundër këtyre zgjidhjeve ligjore, që u mbështet nga institucionet e tjera fetare, organizatat e shoqërisë civile dhe shoqatat që janë pjesë e konceptit kundër gjinisë, si dhe partitë politike.

Media sociale është një nga mjetet kryesore për krijimin dhe përhapjen e dezinformatave gjinore, duke pasur parasysh se, veçanërisht në kontekstin maqedonas, ajo dëshmon të jetë një terren pjellor për krijimin dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes me bazë gjinore dhe ngacmimit me bazë gjinore, kryesisht duke përjetësuar stereotipet gjinore në hapësirën online.<sup>22</sup> Përveç kësaj, mediat kanë një rol të rëndësishëm në krijimin dhe ndarjen e dezinformatave, pasi janë pikërisht publikimet e raporteve gazetareske në mediat sociale që më së shpeshti përbëjnë bazën për krijimin e këtyre përmbajtjeve, të cilat shumë rrallë i nënshtrohen rregullimit nga vetë mediat.

Sfera tradicionale mediatike e informimit publik në Maqedoninë e Veriut rregullohet me Ligjin për media<sup>23</sup> dhe Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.<sup>24</sup> Edhe pse këto ligje nuk i rregullojnë mediat online, ka një numër ligjesh të tjera që i rregullojnë ato në një farë mënyre, duke përfshirë: Kodin penal, Ligjin për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje, Ligjin për të drejtën e autorit

21 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 258/20. Në dispozicion në: <https://www.mtsp.gov.mk/content/%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%81%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%87%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5%20%D0%B8%20%D0%B7%D0%B0%D1%88%D1%82%D0%B8%D1%82%D0%B0%20%D0%BE%D0%B4%20%D0%B4%D0%B8%D1%81%D0%BA%D1%80%D0%B8%D0%BC%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0.pdf>

22 Jovanovska, B. dhe Jovanovska, J. (2023). *Analiza e përmbajtjes me bazë gjinore: Gjuha e urrejtjes seksiste ndaj vajzave të reja*. Instituti për Studime të Komunikimit. Në dispozicion në: <https://iks-edu-mk.b-cdn.net/wp-content/uploads/2023/08/seksistichki-govor-na-omraza-kon-mladi-devojki-mk.pdf>

23 Ligji për mediat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 184/12

24 Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 184/13

dhe të drejtat e përafërta, Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, Ligjin për qasje të lirë në informata me karakter publik, Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, Ligjin për marrëdhënie pune, Ligjin për materialin arkivor, Ligjin për tregtinë elektronike dhe të tjera. Siç u përmend në analizën e mëparshme të përmbajtjes me bazë gjinore, aktualisht nuk ka rregullim të mediave sociale në vend, duke krijuar kështu një vakum në të cilin gjuha e urrejtjes dhe përhapja e përmbajtjes së dëmshme janë të pranishme.<sup>25</sup> Për më tepër, edhe pse mediat online janë subjekt i rregullimit në Ligjin për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje, i cili mbulon termin “publikime elektronike” si media përmes të cilave mund të kryhen fyerje dhe shpifje, kjo nuk vlen për gjuhën e urrejtjes.

Sipas “Udhëzimeve për Raportimin Etik të Mediave Online”,<sup>26</sup> online mediat nuk duhet të fshehin ose të heshtin informacione të rëndësishme, publikimi i të cilave mund të ndikojë në interpretimin ose kuptimin e përmbajtjes së raportit nga lexuesit, ku heshtja e fakteve që mund të ndikojnë ndjeshëm në formimin e një qëndrimi në lidhje me një ngjarje ose person është e barabartë me shtrembërimin e qëllimshëm të realitetit dhe krijimin e dezinformatave. Kur transmetohen pretendime tek subjektet politike ose burime të tjera, media duhet të përpiqet sa herë që është e mundur t’i verifikojë ato pretendime, pra jo vetëm të jetë transmetuese e “fakteve të servitura” nga dikush tjetër, duke i mundësuar kështu audiencës të bëjë dallimin midis fakteve dhe spekulimeve ose dezinformatave, veçanërisht kur bëhet fjalë për ngjarje dhe tema të rëndësishme dhe aktuale. Për më tepër, media online nuk duhet të nxisë kurrë urrejtje ose intolerancë për arsye të ndryshme, duke përfshirë gjininë, seksin, orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Ato duhet të përpiqen të rrisin ndërgjegjësimin për pasojat negative të gjuhës së urrejtjes, të identifikojnë dhe ekspozojnë një gjuhë të tillë, si dhe të vënë në dukje aktorët që e prodhojnë dhe e përdorin atë, dhe të krijojnë përmbajtje që do të luftojnë gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin mbi baza të ndryshme. Gjithashtu, online mediat janë përgjegjëse për rishikimin dhe heqjen e shpejtë të komenteve të përdoruesve që publikohen nën përmbajtjen gazetareske në ueb

25 Jovanovska, B. dhe Jovanovska, J. (2023). *Analiza e përmbajtjes me bazë gjinore: Gjuha e urrejtjes seksiste ndaj vajzave të reja*. Instituti për Studime të Komunikimit. Në dispozicion në: <https://iks-edu-mk.b-cdn.net/wp-content/uploads/2023/08/seksistichki-govor-na-omraza-kon-mladi-devojki-mk.pdf>

26 Në dispozicion në: <https://www.semm.mk/attachments/01-02-2021/%D0%9D%D0%B0%D1%81%D0%BE%D0%BA%D0%B8%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%B5%D1%82%D0%B8%D1%87%D0%BA%D0%BE%20%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%81%D1%82%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B5%20%D0%B2%D0%BE%20%D0%BE%D0%BD%D0%BB%D0%B0%D1%98%D0%BD%20%D0%BC%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%83%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5.pdf>


faqet ose rrjetet sociale, të cilat përmbajnë gjuhë urrejtjeje dhe kanë potencialin të shkaktojnë pasoja të dëmshme në shoqëri.

Lidhur me barazinë gjinore, roli i medias rregullohet në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, i<sup>27</sup> cili i kushton rëndësi të veçantë rolit të tyre parandalues duke promovuar barazinë gjinore, thyerjen e stereotipeve gjinore, ndërgjegjësimin e publikut për format e dhunës me bazë gjinore dhe pasojat e rënda që dhuna me bazë gjinore ka mbi gratë dhe shoqërinë. Për më tepër, ajo që është e rëndësishme të përmendet në kontekstin e kësaj analize është se teksti i Propozim-ligjit për barazinë gjinore në një pjesë të veçantë thekson edhe rolin e mediave, të cilat përmes programeve dhe përmbajtjes së tyre janë të detyruara të kontribuojnë në zhvillimin dhe ngritjen e vetëdijes për barazinë gjinore, si dhe detyrimin të mos transmetojnë programe që përhapin ide për inferioritetin e grave dhe që inkurajojnë diskriminimin.<sup>28</sup> Përveç kësaj, shfaqja publike dhe përfaqësimi i një personi ose grupi në media sipas ligjit të ri nuk duhet të bëhet në mënyrë ofenduese, nënçmuese ose degraduese, bazuar në identitetin gjinor, seksin dhe identitetin gjinor, duke marrë parasysh se diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes janë të ndaluara me ligj.<sup>29</sup>

27 Ligj për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 24/21

28 ENER. Propozim-ligji për barazinë gjinore. Në dispozicion në: [https://ener.gov.mk/files/propisi\\_files/ria1/11\\_1043522045%D0%9D%D0%B0%D1%86%D1%80%D1%82%20-%20%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD\\_%D0%9F%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BB%D0%BE%D0%B3%20%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%80%D0%BE%D0%B4%D0%BE%D0%B2%D0%B0%20%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82%20\\_1.pdf](https://ener.gov.mk/files/propisi_files/ria1/11_1043522045%D0%9D%D0%B0%D1%86%D1%80%D1%82%20-%20%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD_%D0%9F%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BB%D0%BE%D0%B3%20%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%80%D0%BE%D0%B4%D0%BE%D0%B2%D0%B0%20%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82%20_1.pdf)

29 Ibid.



# Studim i Rastit

## **Me gjini dezinformata në mediat maqedonase**

Si pjesë e këtij studimi, u analizuan më shumë se 1,000 raporte gazetareske të publikuara në mediat sociale në periudhën nga maji deri në korrik 2023, si dhe rreth 7,000 komente në postimet e mediave sociale, përkatësisht në platformën Facebook, në lidhje me temën e këtij studimi.

Kjo analizë fillon me njëzet raporte gazetareske që fillojnë të publikohen më 5 maj, përmes të cilave një pjesë e madhe e mediave raportojnë një deklaratë të përbashkët nga pesë udhëheqës të komuniteteve fetare në vend: KOM, Bashkësia Fetare Islame (BFI), Kisha Katolike (KK), Kisha Metodiste Ungjillore (KMU) dhe Komuniteti Hebre (KH) për tërheqjen e Propozim-ligjit për barazi gjinore dhe ndryshimet në Ligjin për evidencën amzë. Të inkurajuar nga njoftimi për miratimin e këtyre dy ligjeve, udhëheqësit fetarë shprehën shqetësimin për të ardhmen dhe sigurinë e besimtarëve për të cilët ata thonë se kanë përgjegjësi, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, duke paralajmëruar se *ideologjia gjinore është një realitet me pasoja tragjike*. Në deklaratë thuhet se propozim-ligjet bien ndesh me doktrinën e të gjitha komuniteteve fetare dhe se sipas mendimit të tyre *njohja ligjore e “identitetit gjinor” në këto ligje është e papranueshme, si dhe dallimi konfuz midis gjinisë, seksit dhe identitetit gjinor, dhe se duke i miratuar ato, në vend të*

*mbrojtjes së tyre, ekziston mundësia për diskriminim ndaj më të rrezikuarave - grave dhe fëmijëve. Sipas njoftimit të transmetuar, është veçanërisht problematike përfshirja e të miturve me ligjin, që besojnë se do të ndikojë në promovimin e identiteteve të ndryshme gjinore dhe “rrjedhshmërinë” midis tyre, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme, veçanërisht në mesin e adoleshentëve, të cilët, të referuar dhe të arsimuar në këtë mënyrë, duhet të kalojnë nëpër një proces vetë-ekzaminimi dhe testimi, të papërshtatshëm për moshën e tyre. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të përmendet se kontradikta në zgjidhjet ligjore të doktrinave fetare është e parëndësishme, duke pasur parasysh se Maqedonia e Veriut është një shtet laik dhe fokusi duhet të jetë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sesa dogmat fetare. Nuk ka asnjë shpjegim se si ligjet do të ishin diskriminuese për gratë dhe fëmijët, kur pikërisht Ligji për barazi gjinore synon mbrojtjen e tyre, duke siguruar një sërë masa të përgjithshme dhe të veçanta për integrimin e barazisë gjinore në të gjitha sferat e shoqërisë. Përveç kësaj, termat «gjini» dhe «identitet gjinor» nuk përfaqësojnë diçka të panjohur ose të re në legjislacionin maqedonas dhe vetë nuk «promovojnë» identitete të ndryshme, por përkundrazi, ndihmojnë personat që ndjehen të përjashtuar nga shoqëria sepse nuk i përkasin kategorizimit të supozuar binar të gjinisë, të njihen dhe të përfshihen. Pothuajse të gjitha raportet gazetareske përcjellin njoftimin pa ndonjë rishikim kritik të informacionit të përcjellë, ndërsa përdoren gjithashtu tituj sensacionalistë, si dhe **EDHE ZOTIT NUK I PËLQEN Udhëheqësit fetarë në Maqedoni kundërshtojnë idenë e rrjedhshmërisë konfuze të identiteteve gjinore**<sup>30</sup>, por edhe të pasakta, si titulli **PROFTËRINJTË DHE HOXHALLARËT U BASHKUAN KUNDËR GRAVE: Udhëheqësit e pesë komuniteteve fetare me një qëndrim të përbashkët kundër Propozim-ligjit për barazinë gjinore, i**<sup>31</sup> cili nga ana tjetër bie ndesh me pozicionin e komuniteteve fetare, narrativi i të cilëve bazohet në mbrojtjen e grave dhe fëmijëve.*

30 Në dispozicion në: <https://plusinfo.mk/i-na-bog-toa-ne-mu-se-dopa-a-verskite-lideri-vo-makedoni-a-se-protivat-na-ide-ata-za-zbunuvachkata-fluidnost-na-rodovite-identiteti/>

31 |||UNTRANSLATED\_CONTENT\_START||| Достапно на: <https://maktel.mk/slider/%D0%BF%D0%BE%D0%BF%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B8-%D0%BE%D1%9F%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D1%81%D0%B5-%D0%B7%D0%B4%D1%80%D1%83%D0%B6%D0%B8%D1%98%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%BE%D1%82%D0%B8%D0%B2-%D0%B6%D0%B5/> |||UNTRANSLATED\_CONTENT\_END|||





Burimi - [www.vecer.press](http://www.vecer.press)

Në periudhën në vijim, paraqiten disa raporte gazetareske me informacion në lidhje me shfaqjen publike të filmit “Çfarë është grua?” të Matt Walsh në Strumicë dhe qytete të tjera në vend. Matt Walsh, i cili e karakterizon veten si një “fashist teokratik”, është komentator politik amerikan i diskutueshëm dhe konservator, i cili u emërua “Transfobi i vitit” nga Nju Republik, në vitin 2022.<sup>32</sup> Filmi riafirmon stereotipet gjinore dhe përdor argumentim të njëanshëm (atë të Walsh), duke banalizuar ekspertizën e ekspertëve, përfshirë mjekët, që punojnë për dhe me njerëzit transgjinorë, që në thelb synon të dehumanizojë dhe demonizojë njerëzit transgjinorë dhe mbështetësit e tyre. Megjithatë, mediat nuk japin informacion shtesë për filmin, as për prejardhjen e krijuesit të tij. Ministrja Jovana Trençevska reagoi ndaj këtyre postimeve përmes faqes së saj në Facebook, duke iu referuar polemikave të Walsh, duke thënë me ironi se pas 53 vjetësh dikush më në fund do ta “ndriçojë” atë nëse është grua. Disa raporte gazetareske përcjellin reagimin e ministres, por edhe reagimin e organizatorëve ndaj projeksioneve dhe publikimit të saj, ku thuhet se etiketon Matt Walsh dhe filmin e tij, por nuk thotë se nuk i pëlqen sepse *plastifikon propozim-ligjin tuaj për barazinë gjinore, sipas të cilit gratë mund të kenë penis dhe burrat mund të lindin.*<sup>33</sup> Përveç faktit që organizatorët duket se vetëm spekulojnë pse ministrja nuk e pëlqen filmin, lidhja e filmit me Ligjin

32 Në dispozicion në: <https://newrepublic.com/article/169609/transphobe-year-matt-walsh>

33 Në dispozicion në: <https://plusinfo.mk/ministerke-ne-ve-pla-aat-da-si-igrate-ma-tap-na-fe-sbuk-trenchevska-vo-vo-na-na-tema-shto-e-zhena-i-dali-taa-mozhe-da-ima-penis/>

për barazi gjinore është përsëri e papërshtatshme, pasi çështja e ndryshimit gjinor nuk rregullohet me këtë ligj. Por asnjë nga raportet nuk ballafaqon argumentet e të dyja palëve, as nuk i rishqyrton ato në mënyrë kritike.

Më 24 maj, disa media raportuan për vendimin e komunës së Novo Selos për të hequr termin “barazi gjinore” nga Programi i Mundësive të Barabarta dhe për ta zëvendësuar atë me termin “mundësi të barabarta të grave dhe burrave”, duke ndjekur shembullin e fundit të komunës së Strumicës. Nëpërmjet titujve të tillë si **Novo Selo përcaktoi se çfarë është burrë dhe çfarë është grua**<sup>34</sup> dhe **BRAVO: U HOQ TERMI “BARAZI GJINORE”, KOMUNA E NOVO SELOS PËRCAKTOI SE ÇFARË ËSHTË BURRË DHE ÇFARË ËSHTË GRUA!**<sup>35</sup>, raportet gazetareske përcjellin deklaratën e kryetarit të komunës se qëllimi është që qytetarët të mos lejohen të *manipulohen terminologjikisht*.<sup>36</sup> Raportet përsëri e përcjellin lajmin në mënyrë sipërfaqësore dhe lejojnë përhapjen e dezinformatave, duke pasur parasysh se manipulimi i vetëm terminologjik në këtë rast është bërë nga kryetari i komunës, sepse, siç u përmend, termi “barazi gjinore” ka qenë pjesë e politikave dhe legjislacionit maqedonas për vite me radhë.

17 maji është Dita Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë, dhe përafërsisht vetëm njëzet media publikojnë raporte gazetareske në lidhje me festimin e ditës në Kuvend, si dhe situatën e komunitetit LGBTI+ në vend. Vetëm disa media raportojnë një pjesë të fjalimit në Kuvend të aktivistes për të drejtat e personave transgjinorë - Lila Miliq, në të cilën ajo apelon për miratimin e ndryshimeve në Ligjin për evidencën amzë, i cili do t’u lejojë personave transgjinorë të përdorin shërbimet pa pengesa si gjithë qytetarët e tjerë në vend. Kështu, raportimi në media është sipërfaqësor dhe nuk lidhet me ngjarjet aktuale dhe nuk përdorin mundësinë për të vënë në dukje diskriminimin me të cilin përballen personat nga komuniteti LGBTI+, as se si ndryshimet në ligj do të kontribuojnë në përmirësimin e mirëqenies së tyre.

34 Në dispozicion në: <https://nezavisen.mk/novo-selo-utvr-di-shto-e-mazh-a-shto-zhena/>

35 Në dispozicion në: <https://strumicadenes.mk/opstini/strumica/bravo-isfrlen-terminot-rodova-ednakvost-opshtina-novo-selo-utvr-di-shto-e-mazh-a-shto-zhena/>

36 <https://www.vecer.press/%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%BE-%D1%81%D0%B5%D0%BB%D0%BE-%D1%83%D1%82%D0%B2%D1%80%D0%B4%D0%B8-%D1%88%D1%82%D0%BE-%D0%B5-%D0%BC%D0%B0%D0%B6-%D0%B0-%D1%88%D1%82%D0%BE-%D0%B6%D0%B5%D0%BD%D0%B0/>



Burimi - [www.vecer.press](http://www.vecer.press)

Më 1 qershor, në organizim të MPPS-ë, mbahet debat publik për Ligjin për barazi gjinore në Strumicë, i cili transmetohet vetëm nga disa raporte gazetareske, në të cilat transmetohet vetëm një pjesë e vogël e debatit për ligjin, ekskluzivisht duke transferuar pjesë të deklaratave të ministres Trençevska dhe kryetarit të Komunës së Strumicës, Kostadin Kostadinov. Përveç kësaj, ministrja Trençevska thekson se konfuzioni është krijuar nga përzierja e dy ligjeve, përkatësisht se *Ligji për barazi gjinore nuk flet për njohjen ligjore të gjinisë, por flet për mekanizmat gjinorë që ekzistojnë në nivel lokal, në Kuvend, në organet e administratës shtetërore, dhe se termi barazi gjinore ka qenë prej kohësh pjesë e politikave dhe ligjeve maqedonase.* Nga ana tjetër, kryetari i komunës Kostadinov i referohet sjelljes së OJQ-ve që ai beson se e ofenduan atë dhe komunën, por edhe KOM, nga e cila kërkon falje. Përsëri, mediat nuk futen në thelbin e deklaratave të folësve, as nuk i konfrontojnë ato, por vetëm i përcjellin në mënyrë sipërfaqësore.

Disa media raportojnë deklaratën e ministres Trençevska të dhënë në tribunën e LSDM-së në Kavadar më 11 qershor ku, ndër të tjera, ajo thotë se *qëllimi kryesor i barazisë gjinore është realizimi i mundësive të barabarta për burrat dhe gratë, promovimi i parimit të pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat e sektorit publik dhe privat, statusi dhe trajtimi i barabartë në realizimin e të gjitha të drejtave dhe në zhvillimin e potencialeve të tyre individuale, përmes të cilave*

*kontribuojnë në zhvillimin shoqëror, si dhe përfitime të barabarta nga rezultatet që dalin nga ai zhvillim.*<sup>37</sup>

Lajmet në lidhje me protestën kundër dy ligjeve, të organizuar nga Kisha Ortodokse Maqedonase në Shkup, fillojnë më 20 qershor. Më shumë se 50 raporte gazetareske përcjellin thirrjen për protestë në ditët në vijim, përmes titujve të tillë si **FËMIJËT KANË BABA DHE NËNË, JO PRINDI 1 DHE PRINDI 2** Kisha është kundër ligjit për barazinë gjinore dhe për këtë arsye bën thirrje për një protestë, e<sup>38</sup> cila nga ana tjetër është një narrative që ishte aktuale në kuadër të përpjekjeve të lëvizjeve kundër gjinore, kundër Konceptit të Arsimit Fillor dhe Edukimit Gjithëpërfshirës seksual. Përdorimi i kësaj narrative sugjeron një lidhje midis dy ligjeve dhe të drejtës për martesë të personave të të njëjtit seks, e cila në thelb fillon të bëhet narrativi mbizotërues në periudhën e ardhshme, edhe pse asnjë nga këto ligje nuk e rregullon atë. Raportet gazetareske theksojnë se KOM bën thirrje *në këtë luftë për dinjitet, liri dhe mbrojtje të të drejtave themelore fetare t'i mbështesë populli besnik, shoqatat e shoqërisë civile, organizatat dhe të gjithë mbështetësit së bashku për të mbrojtur besimin dhe traditën tonë nga përpjekja për ta çrrënjësuar 'atë të përmendur në nenin 23, pika 5 të propozim-ligjit.*<sup>39</sup> Neni i propozim-ligjit për barazi gjinore i referuar në njoftim i referohet një prej kompetencave të Komisionit për Barazi Gjinore në Kuvend në kuadër të të cilit ajo *inicion dhe promovon aktivitete për ndryshime sociale dhe kulturore me qëllim të çrrënjësjes së paragjykimeve, stereotipeve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera të dëmshme në realizimin e barazisë gjinore.*<sup>40</sup> Duke marrë parasysh se të gjitha hulumtimet e mëparshme, si dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, përfshirë raportin e fundit të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave në Kombet e Bashkuara,<sup>41</sup> tregojnë ndikimin e dëmshëm të stereotipeve, paragjykimeve dhe praktikave gjinore në vazhden dhe normalizimin e dhunës dhe diskriminimit ndaj grave dhe vajzave në shoqëri, interpretimi i nenit në fjalë

37 Në dispozicion në: <https://zoom.mk/trenchevska-grizha-za-gra%D1%93anite-zashtita-poddrshka-vo-seko%D1%98-period-vo-zhivotot-e-prioritet-na-vladata/>

38 Në dispozicion në: <https://plusinfo.mk/decata-imaat-tatko-i-ma-ka-a-ne-roditel-1-i-roditel-2-crkvata-e-protiv-zakonot-za-rodova-ednakvost-i-zatoa-povikuva-na-protest/>

39 Në dispozicion në: <https://360stepeni.mk/mpts-oa-povikuva-na-protest-na-29-juni-vo-skopje-protiv-predlog-zaknite-za-matichna-evidentsija-i-rodova-ednakvost/>

40 ENER. Propozim-ligji për barazinë gjinore. Në dispozicion në: [https://ener.gov.mk/files/propisi\\_files/ria1/11\\_1043522045%D0%9D%D0%B0%D1%86%D1%80%D1%82%20-%20%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD\\_%D0%9F%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BB%D0%BE%D0%B3%20%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%80%D0%BE%D0%B4%D0%BE%D0%B2%D0%B0%20%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82%20\\_1.pdf](https://ener.gov.mk/files/propisi_files/ria1/11_1043522045%D0%9D%D0%B0%D1%86%D1%80%D1%82%20-%20%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD_%D0%9F%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BB%D0%BE%D0%B3%20%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%80%D0%BE%D0%B4%D0%BE%D0%B2%D0%B0%20%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82%20_1.pdf)

41 CEDAW. (2018). *Concluding observations on the sixth periodic report of the former Yugoslav Republic of Macedonia*. Në dispozicion në: [https://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2FC%2FMKD%2FCO%2F6&Lang=en](https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2FC%2FMKD%2FCO%2F6&Lang=en)

nga KOM është manipulues dhe nuk i referohet aspak çrrënjosjes së besimit dhe traditës, për sa kohë që ato nuk kanë pasoja të dëmshme. Kjo narrativë e ngarkuar emocionalisht për “rrezikimin e të drejtave fetare”, e cila mund të reduktohet vetëm në rrezikimin e pozitës tradicionalisht inferiore të grave, është përdorur për të krijuar një ndjenjë frike kolektive dhe rrezikimi të “jashtë”.

Dhjetëra raporte gazetareske raportojnë fjalimin e ministres Trençevska në një konferencë në Malin e Zi, ku ajo thekson shqetësimet se *rrjetet sociale në muajt e fundit kanë qenë vendi për organizimin e lëvizjeve të para kundër konceptit gjinor në vendin tonë, të cilat janë plot me gjuhë urretjeje, nënçmuese, stigmatizuese, ofenduese*,<sup>42</sup> duke deklaruar se qëllimi i tyre për momentin është Ligji i ri për barazi gjinore.

Disa raporte gazetareske të publikuara më 21 qershor përcollën qëndrimin e Kryetarit të Komunës së Strumicës Kostadinov të publikuar në rrjetet sociale në të cilën ai kërcënoi me veto dhe pavlefshmëri të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile që kanë një qëndrim kritik ndaj mbështetjes së tij në lidhje me ligjet për barazinë gjinore dhe për evidencën amzë, të organizuara nga Fondacioni “Eleusa”. Që të nesërmen u publikuan disa raporte me reagimin e Platformës për barazi gjinore me rastin e këtyre deklaratave të kryetarit të komunës. Në njoftimin për shtyp, përfaqësuesit e Platformës besojnë se ndarja e bërë nga kryetari i komunës së organizatave të shoqërisë civile *krijon polarizim shtesë midis qytetarëve dhe inkurajon gjuhën e urretjes, dhunën*<sup>43</sup> *dhe intolerancën* dhe theksojnë nevojën për miratimin e Ligjit për barazi gjinore me qëllim përmirësimin e pozitës së grave në shoqëri.

Më 24 qershor mbahet Parada e Krenarisë në Shkup, për të cilën raportohet nga rreth njëzet media. Shumica e mediave përqendrohen në pjesëmarrjen e politikanëve të ndryshëm në këtë ngjarje, pa treguar qëllimin e Paradës dhe Paradave të Krenarisë në përgjithësi. Megjithëse një numër më i vogël i mediave raportojnë për ngjarjen, komentet në postimet e mediave sociale bëhen burim i gjuhës së qartë të urretjes dhe thirrjeve për dhunë ndaj popullsisë LGBTI+, por edhe ndaj mbështetësve të tyre politikë, përfshirë disa ministra dhe deputete femra.

42 Në dispozicion në: <https://utrinskivesnik.mk/trenchevska-eliminira-e-na-govorot-na-omraza-i-diskriminacata-se-kluchni-vo-ostvaruva-eto-na-chovekovite-prava/>

43 Në dispozicion në: <https://mkd.mk/node/518892>

Më 26 qershor, vetëm disa raporte gazetareske publikuan vendimin e Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (KPMD), i cili zbuloi se peshkopi Jakov Stobiski kishte kryer diskriminim në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në fushën e informimit publik dhe mediave. Megjithatë, gjatë të njëjtës ditë, publikohen raporte me reagimin e peshkopit në lidhje me vendimin e KPMD, të cilin ai e quan një *farsë ligjore* dhe *vendim totalitar* që lidh Ligjin për barazi gjinore, duke pretenduar se ai nuk do të kërkojë falje për veprimet e tij madje edhe sikur të përfundojë në gjykatë.<sup>44</sup> Megjithëse KPMD rekomandon që episkopi të përmbahet nga paraqitjet publike në të cilat do të flasë për identitetin gjinor, megjithatë në ditët në vijim publikohen raporte të shumta gazetareske me deklaratat e tij nga paraqitjet dhe intervistat publike, përmes të cilave mundësojnë që promovimi i “heroizmit” të tij të mos tërhiqet nga pikëpamjet e tij, duke mos i shqyrtuar këto veprime në përputhje me ligjin.

Numri i raporteve gazetareske (më shumë se 100) në lidhje me protestën u rrit vetëm disa ditë para se të mbahej. Në raportet gazetareske me tituj si z.z **Stefan: Kemi detyrë të shenjtë për të vazhduar atë që kemi marrë dhe trashëguar**<sup>45</sup> nga **paraardhësit tanë**, video-mesazhi nga kreu i KOM, z.z. Stefan, me thirrje për protestë nën moton “Kemi detyrë”, publikuar më 26 qershor, në të cilën thuhet se *ligjet e propozuara i referohen një sërë elementesh të diskutueshme nga ekspertë, profesionistë dhe qytetarë, por nuk merren parasysh dhe se ligjet përpiqen t'i miratojnë sa më shpejt dhe në mënyrë jo transparente, në dëm të qytetarëve, veçanërisht grave dhe fëmijëve*. Njëkohësisht, deklarata përsëri përcillet në mënyrë jokritike, nga njëra anë pa shqyrtuar ekspertizën me të cilën kisha disponon për këto çështje, nga ana tjetër, dhe pa marrë parasysh faktin se për të dy ligjet u formuan grupet e punës të përbëra nga përfaqësues të të gjitha institucioneve përkatëse, organizatave dhe ekspertëve të problematikës përkatëse në vend, nga parti të ndryshme politike, të cilët kanë punuar për zgjidhjet e reja ligjore për më shumë se dy vjet. Nëpërmjet transmetimit të njëanshëm dhe jokritik të deklaratave të klerikut që flet nga një pozicion pushteti, media lë hapësirë që pikëpamjet e tij të pranohen pa kushte nga audienca, pa përcaktuar dëmin që do të shkaktohet nga miratimi i ligjeve.

44 Në dispozicion në: <https://plusinfo.mk/nema-da-se-izvinam-i-nema-da-zamolcham-podgotven-sum-za-svoite-stavovi-da-odam-na-sud-episkop-akov-vrati-na-komisi-ata-za-sprechuva-e-diskriminaci-a/>

45 Në dispozicion në: <https://novamakedonija.com.mk/makedonija/g-g-stefan-imame-sveta-dolznhnost-da-go-prodolzhime-ona-shto-sme-go-primile-i-nasledile-od-predcite/>

Për më tepër, ditën e ardhshme u mbajt konferencë për shtyp e Sinodit të KOM për protestën, e udhëhequr nga peshkopi Jakob, i cili deklaroi se me këto ligje *ndiejmë se po ushtrohet dhunë kundër vullnetit të popullit*. Konferenca përshkroi pikat kryesore të ligjeve të cilat i pengojnë Kishës, përkatësisht ndryshimet në Ligjin për evidencën amzë që lejojnë ndryshimin e gjinisë me deklaratë në noter, e cila do të bazohet në ndjenjat subjektive dhe individuale të individit, si dhe kufizimin e lirisë së fjalës, e cila sipas Kishës sigurohet përmes nenit për gjuhën e ndjeshme gjinore. Sipas propozim-ligjit të ri, përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore *nënkupton realizimin e barazisë gjinore në gjuhën e shkruar dhe të folur, e cila arrihet kur gratë dhe burrat dhe ata që nuk bëjnë pjesë në sistemin binar gjinor bëhen të dukshëm dhe përfshihen nga gjuha si njerëz me vlerë, dinjitet, integritet<sup>46</sup> dhe respekt të barabartë dhe është një nga masat e përgjithshme për arritjen e barazisë gjinore*. Megjithatë, Kisha jep një interpretim të pasaktë të këtij neni, sepse sipas tekstit të ligjit, kjo masë ka për qëllim të vetëm sigurimin e gjithëpërfshirjes së grupeve të caktuara të përjashtuara të shoqërisë, përmes përdorimit të gjuhës që korrespondon me gjininë që identifikon një person të caktuar, por edhe për të inkurajuar përdorimin e (më shpesh) feminativave në gjuhën e shkruar dhe të folur, duke qenë se ato tashmë janë pjesë e gjuhës maqedonase. Shumica e titujve përdorin deklaratë sensacionaliste nga konferenca, si **Jakov Stobiski: Ligjet janë një konstrukt monstruoz, ato hapin mundësinë që gjini të ndryshme të dalin çdo ditë, ndërsa organizatat joqeveritare janë mercenarë<sup>47</sup> dhe Peshkopi Jakob: Kisha nuk do të mund të predikojë besimin nëse miratohen ligjet për barazinë gjinore dhe evidencën amzë.<sup>48</sup>** Peshkopi, nga njëra anë, mbjell urrejtje dhe intolerancë ndaj organizatave joqeveritare, duke injoruar se disa nga mbështetësit më të mëdhenj të protestës janë pikërisht organizatat joqeveritare dhe përsërit deklaratën manipuluese për rrezikimin e predikimit fetar me zgjidhje të reja ligjore. Duke vepruar kështu, peshkopi deklaroi se *ne nuk jemi kundër askujt, veçanërisht jo kundër ushtrimit të të drejtave të askujt. Ne protestojmë për atë që është e diskutueshme në ligjet, besojmë se realizimi serioz mund të kontribuojë në ushtrimin më të madh të të drejtave të dikujt, individëve, por kjo do të rrezikonte seriozisht të*

46 ENER. Propozim-ligji për barazinë gjinore. Në dispozicion në: [https://ener.gov.mk/files/propisi\\_files/ria1/11\\_1043522045%D0%9D%D0%B0%D1%86%D1%80%D1%82%20-%20%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD\\_%D0%9F%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BB%D0%BE%D0%B3%20%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%80%D0%BE%D0%B4%D0%BE%D0%B2%D0%B0%20%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82%20\\_1.pdf](https://ener.gov.mk/files/propisi_files/ria1/11_1043522045%D0%9D%D0%B0%D1%86%D1%80%D1%82%20-%20%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD_%D0%9F%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BB%D0%BE%D0%B3%20%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%20%D0%B7%D0%B0%20%D1%80%D0%BE%D0%B4%D0%BE%D0%B2%D0%B0%20%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B0%D0%BA%D0%B2%D0%BE%D1%81%D1%82%20_1.pdf)

47 Në dispozicion në: <https://telma.com.mk/2023/06/27/jakov-stobiski-zakonite-se-chudovishen-konstrukt-otvoraat-mozhnost-sekoj-den-da-izleguvaat-raznorazni-rodovi-a-nevladinite-se-platenici/>

48 Në dispozicion në: <https://republika.mk/vesti/makedonija/episkopot-jakov-tsrkvata-ne-ke-mozhe-da-propoveda-vera-ako-se-donesat-zakonite-za-rodova-ednakvost-i-matichna-evidentsija/>

*drejtat e shumicës, ose 99 përqind të popullsisë në Maqedoni.*<sup>49</sup> Raportet gazetareske përsëri nuk arrijnë të trajtojnë vërtetësinë e informacionit që përcillet, pasi kjo deklaratë e peshkopit është manipuluese dhe bazohet në të pavërteta në disa aspekte. Para së gjithash, nëse bëhet fjalë për barazi gjinore, ligji do të kontribuonte në promovimin e të gjithë mekanizmave institucionalë për përmirësimin e të drejtave (mbi të gjitha) të grave në shoqëri, të cilat, sipas regjistrimit më të fundit në vend, përbëjnë më shumë se 50% të popullsisë, ndërsa Ligji për evidencën amë do t'u lejojë personave transgjinorë të ushtrojnë të drejtat themelore, siç është qasja në shërbimet shëndetësore. Përveç kësaj, peshkopi manipulon përmes ekzagjerimit të numrit të besimtarëve në vend.

Në të njëjtën kohë, disa raporte gazetareske përcjellin deklaratën e Komitetit Ekzekutiv të LSDM-së për vendimin se nevojitet një debat më i gjerë publik mbi ligjet, i cili përsëri është vetëm raportim sipërfaqësor, pa dhënë një përkrahim më të detajuar të tij.

Më 28 qershor, dhjetëra raporte gazetareske raportuan mbi reagimin e Platformës për Barazi Gjinore dhe Rrjetit për Mbrojtje nga Diskriminimi, sipas të cilëve KOM përdor statistika të pasakta për numrin e besimtarëve në vend dhe *manipulon pretendimet se propozim-ligjet vazhduan në formë të shkurtër për të gjithë filtrat parlamentarë, gjegjësisht se e vërteta është se Ligji për evidencën amë është në procedurë të rregullt, ndërsa Ligji për barazinë gjinore nuk është aspak në procedurë parlamentare.*<sup>50</sup> Njoftimi vë në dukje *ndërrhyrjen e Kishës në këto propozim-ligje si një ndërrhyrje e drejtpërdrejtë në laicitetin e shtetit dhe mos respektim të Kushtetutës*, e cila nuk trajtohet nga media gjatë kësaj periudhe, megjithëse është një nga themelet e rendit shoqëror në vend. Raportimi i mediave përsëri nuk i kushton vëmendje shtesë informacioneve në njoftim dhe në vend që mediat të jenë ato që krijojnë agjendën mediatike, ato e bazojnë raportimin në reagime dhe informacione sipërfaqësore.

Disa raporte gazetareske gjithashtu publikuan përgjigjen e pyetjes së një gazetari në lidhje me ndërtimin e 20 katësheve në Holiday Inn, ndërsa peshkopi tha se nuk

49 Në dispozicion në: <https://360stepeni.mk/video-mpts-oa-spornite-predlog-zakoni-ovozmozhuvaat-prava-na-odredeni-litsa-no-ke-gi-zagrozat-na-99-otsto-drugi/>

50 Në dispozicion në: <https://meta.mk/reakcii-i-osuda-na-povikot-za-protest-na-mpc/>



është tema e konferencës për shtyp, domethënë është një temë e parëndësishme dhe një defokusim i kërcënimit që na qëndron përpara.<sup>51</sup>

Gjatë kësaj periudhe u publikuan raporte lajmesh që përcillnin deklaratat nga disa klerikë dhe mbështetës të tjerë të protestës. Për shembull, janë publikuar disa raporte me titujt **Peshkopi David paralajmëron: Deputetët që ngrenë dorën “për” mund të privohen nga pagëzimet, dasmat, funeralet dhe shërbesat kishtare<sup>52</sup>** dhe **Kisha mund të anatemojë deputetët që do të votojnë për ligjin e diskutueshëm, u kërcënuan një peshkop<sup>53</sup>** i cili Peshkopi David propozon që deputetët që do të votojnë “për” Ligjin për barazinë gjinore (të cilin ai gjithashtu e quan ligji për çnjerëzimin) të përjashtohen nga komuniteti i kishës, të privohen nga pagëzimet, dasmat, funeralet dhe shërbesat e tjera kishtare. Ai argumenton se ligji do të lejojë që një grup i vogël transgjnor të imponojë stilin e vet të ekzistencës në të gjithë shoqërinë në një mënyrë totalitare<sup>54</sup>, pa përmendur faktin se peshkopi padyshim po flet për një ligj tjetër. Përveç kësaj, disa raporte përcjellin deklaratën e At Pimen në të cilën **At Pimen thotë: Hap një OJQ dhe fiton të drejtën të përcaktosh vendin e kishës në margjinat e shoqërisë.<sup>55</sup>** Disa raporte gazetareske u publikuan edhe me deklaratat nga prifti Ivica me titujt **Nëse kalon ky Ligj për barazi gjinore, atëherë e ka radhën martesat e të njëjtit seks, birësimi i fëmijëve dhe legalizimi i pedofilisë!<sup>56</sup>** Me këtë seri raportesh gazetareske, mediat hapin mundësi për mbjelljen e frikës nga një person në pozitë të pushtetit, që është një teknikë propagandistike për të treguar epërsi në mesin e publikut, e cila kontribuon në forcimin e pikëpamjeve që i avokon ajo qendër e pushtetit. Në vend që të parandalojnë përhapjen e intolerancës dhe gjuhës së urrejtjes ndaj grupeve të caktuara, media bëhet një instrument për përhapjen e kërcënimeve, frikës dhe urrejtjes ndaj grupeve të caktuara në shoqëri.

51 Në dispozicion në: <https://utrinskivesnik.mk/video-za-mpc-nebitna-tema-i-defokus-se-prasha-ata-za-izgradbata-na-20-katnicite-ka-holide-in/>

52 Në dispozicion në: <https://a1on.mk/macedonia/vladikata-david-prerupreduva-pratenicite-koi-kje-krenat-raka-za-mozhe-da-bidat-lisheni-od-krshtevki-venchavki-pogrebi-i-bogosluzhbi/>

53 Në dispozicion në: <https://www.slobodenpecat.mk/crkvata-mozhe-da-im-frli-anatema-na-pratenicite-koi-kje-glasaat-za-spornite-zakoni-se-zakani-vladika/>

54 Në dispozicion në: <https://www.slobodenpecat.mk/crkvata-mozhe-da-im-frli-anatema-na-pratenicite-koi-kje-glasaat-za-spornite-zakoni-se-zakani-vladika/>

55 Në dispozicion në: <https://maktel.mk/slider/%D0%BE%D1%82%D0%B5%D1%86-%D0%BF%D0%B8%D0%BC%D0%B5%D0%BD-%D0%BE%D1%82%D0%B2%D0%BE%D1%80%D0%B0%D1%88-%D0%BD%D0%B5%D0%B2%D0%BB%D0%B0%D0%B4%D0%B8%D0%BD%D0%B0-%D0%B8-%D0%B4%D0%BE%D0%B1%D0%B8%D0%B2%D0%B0-2/>

56 Në dispozicion në: <https://shilomagazine.com.au/2023/06/28/otec-ivica-ako-pomine-ovoj-zakon-za-rodova-ednakvost-sledno-e-istopolovi-brakovi-posvojuvanje-deca-pa-legalizacija-na-pedofilija/>

Një ditë para protestës, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe disa organizata të tjera të shoqërisë civile lëshuan një apel për sigurinë e komunitetit LGBTI+ në ditën e protestës së KOM-së, si rezultat i numrit në rritje të raporteve të incidenteve dhe sulmeve verbale dhe kërcënimeve ditët e fundit.<sup>57</sup>

Në ditën e protestës, disa media, përveç ndjekjes së protestës, publikuan deklarata të ministres Trençevska, e cila përsëri theksoi se konfuzioni ishte krijuar nga përzierja e dy ligjeve dhe sipas së cilës protesta është një e drejtë legjitime e të gjithëve, por është gjithashtu një e drejtë legjitime për të thënë të vërtetën për dy ligjet, dhe përkufizimet dhe mekanizmat.<sup>58</sup> Në këto raporte, Ministrja përsëriti argumentet lidhur me të dy ligjet, gjegjësisht se Ligji për evidencën amë trajton identitetin gjinor, përmes mundësisë që personat transgjinorë të ndryshojnë emërtimin në numrin identifikues ku shënohet gjinia, ndërsa Ligji për barazi gjinore përqendrohet në promovimin e pozitës së grave në shoqëri, duke theksuar se ligji nuk trajton martesat e gjinisë së njëjtë.

Shumica e raporteve të analizuara u publikuan më 29 qershor, ditën e protestës së organizuar nga KOM, nga të cilat pothuajse 300 përcjellin informacione për vetë protestën. Titujt përdorin pjesë të ndryshme të fjalimit të kreut të KOM: **Kreu i KOM-OA, z.z.Stefan - Gratë nuk duan barazi të rreme dhe të drejta të rreme**<sup>59</sup>, **T'I MBROJMË FËMIJËT NGA PROPAGANDA E PAFE! Kreu z.z. Stefan nga mbledhja kundër ligjeve për barazinë gjinore**<sup>60</sup>, **Të ndalohet denigrimi i sistemit arsimor me ideologjinë gjinore dhe seksualizimin e më të vegjëlve tanë, tha z.z.Stefan**<sup>61</sup>, **KOM është kundër Konventës së Stambollit, rrezikoi gruan, tha z.z. Stefan**<sup>62</sup>. Raportet gazetareske përqendrohen kryesisht në transmetimin e fjalimit të udhëheqësit, dhe një pjesë të fjalimit të akademikes Katica Qulavkova, sipas së cilës ligji kërcënon të drejtat e grave dhe në thelb përqendrohet në të drejtat e individëve

57 Në dispozicion në: <https://fokus.mk/helsinshki-lgbti-lugeto-da-bidat-pomalku-vidlivi-za-vreme-na-protestot-na-mpts/>

58 Në dispozicion në: <https://libertas.mk/trenchevska-zakonot-za-rodova-ednakvost-ne-tretira-menuva-eto-na-pol-nitu-gi-tretira-istopolovite-brakovi/>

59 Në dispozicion në: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/poglavarot-na-mpc--oa-g-g-stefan---zhenite-ne-sakaat-lazhna-ednakvost-i-lazhni-prava/32482611.html>

60 Në dispozicion në: <https://plusinfo.mk/da-gi-odbranime-decata-od-bezbozhnite-propagandi-poglavarot-g-g-stefan-od-sobiro-protiv-zakonite-za-rodova-ednakvost/>

61 Në dispozicion në: <https://lokalno.mk/da-prestane-unakazhuvan-jeto-na-obrazovniot-sistem-so-rodova-ideologija-i-seksualizacija-na-nashite-najmladi-poracha-g-g-stefan/>

62 Në dispozicion në: <https://nezavisen.mk/mpc-e-protiv-istanbulskata-konvencija-ja-zagrozuvata-zhenata-reche-g-g-stefan/>

transgjinorë.<sup>63</sup> Përveç kësaj, raportet nuk theksojnë kontradiktën e tezave të paraqitura në protestë me ekspertizën në dispozicion të kishës, e cila është veçanërisht simbolike nga fotografitë të publikuara në vetë raportet, ku bie në sy se në skenën nga e cila flasin folësit janë 15 burra – priftërinj dhe vetëm një grua. Në fjalën e mbajtur nga z.z. Stefan, ai tha se *këto ligje janë pjesë e një propagande të re ideologjike, që nënkupton termin “gjini”,*<sup>64</sup> që është i pasaktë, duke pasur parasysh përfaqësimin historik të këtij termi në legjislacionin dhe politikat maqedonase. Në fjalimin e mëposhtëm, përcillet se *për shekuj me radhë, në këndvështrimin e saj ndaj gruas, Kisha qëndron me një frikë të shenjtë ndaj gruas, e cila mban në duart e saj të brishta Zotin fuqiplotë. Engjëjt dhe njerëzit dridhen para kësaj force. Ajo ushqen në gjirin e saj atë që u jep ushqim të gjithëve. Nëna grua i jep shpresë botës, dashuri. Një grua është një ikonë e dashurisë. Thonë se do ta çlirojnë gruan nga kufizimet e kishës dhe do ta reduktojnë atë në një nënkategori, duke e barazuar me burrat që kurrë nuk do të jenë gra në kuptimin e vërtetë të fjalës.*<sup>65</sup> Ky citim konfirmon kategorizimin patriarkal të roleve gjinore përmes të cilave një grua reduktohet ekskluzivisht në rolin e nënës, domethënë në funksionin e saj biologjik për të lindur, gjë që përjashton gratë që nuk mund ose nuk duan të kenë fëmijë. Përveç kësaj, përveç që është e pavërtetë, pjesa e fundit e deklaratës është e mbushur me transfobi, duke mbjellë një ndjenjë të rrezikimit të grave “të vërteta” nga gratë transgjinore, përkatësisht duke i barazuar ato me gra “të pavërteta”.

Gjatë ditës së protestës dhe ditëve në vijim, u publikuan raporte gazetareske që përcollën mbështetjen e protestës nga BFI-ja, kryetari i VMRO-DPMNE-së, kryetari i VMRO-PP-së dhe të tjerë. Një media publikon raport që tregon video sondazh të pjesëmarrësve në protestë nga i cili mund të shihet se pjesëmarrësit i lidhin këto dy ligje me të drejtën e martesës së të njëjtit seks, e<sup>66</sup> cila nuk është aspak subjekt i ndryshimeve të propozuara dhe shërben vetëm për të nxitur urrejtje dhe intolerancë ndaj popullsisë LGBTI+.

Më 30 qershor, disa media raportuan fragmente nga intervista e Presidentit Stevo Pendarovski në të cilën ai shprehu shqetësimin e tij pas një proteste nga KOM,

63 Në dispozicion në: <https://novamakedonija.com.mk/makedonija/kjulavkova-zakonot-ne-e-fokusiran-na-zhenite-se-meshaat-poimite-pol-i-rod/>

64 Në dispozicion në: <https://plusinfo.mk/da-gi-odbranime-decata-od-bezbozhnite-propagandi-poglavarot-g-g-stefan-od-sobirov-protiv-zakonite-za-rodova-ednakvost/>

65 Në dispozicion në: <https://nezavisen.mk/mpc-e-protiv-istanbulskata-konvencija-ja-zagrozuvata-zhenata-reche-g-g-stefan/>

66 Në dispozicion në: <https://www.slobodenpecat.mk/video-kje-dojdat-psihichki-nezdravi-generacii-anketa-megju-uchescite-na-protestniot-sobir-na-mpc-oa/>

përkatësisht se sipas mendimit të tij ishte e çuditshme që kisha kishte bërë thirrje për protestë me këtë rast për herë të parë, mendoj se kishim dilema shumë më të vështira me të cilat ballafaqohet kisha dhe shteti. Në të njëjtën kohë, Pendarovski pretendon se *protesta është e pakuptimtë sepse Qeveria tërhoqi nga procedura dy ligjet kundër të cilave protestohej – për barazinë gjinore dhe evidencën amë dhe kërkoi një debat më të gjerë shoqëror.*<sup>67</sup> Sidoqoftë, narrativi kryesor në të cilën përqendrohen të gjitha mediat gjatë raportimit është informacioni që zyrtarët e lartë nga KOM bashkëpunojnë me shërbimet ruse, gjë që Presidenti thotë se *bazohem në raportet e organeve që merren me atë punë. Jo vetëm Agjencia për Kundërzbulim, ne jemi anëtare e NATO-s, nga 30 vende të tjera, nga 30 shërbime të tjera unë marr informacion sepse jemi pjesë e atij sistemi të përbashkët për shkëmbimin e informacionit të inteligjencës dhe sigurisë.* Megjithatë, mediat, përmes raportimit sipërfaqësor dhe sensacionalist, përsëri nuk arrijnë të bëjnë relacion të informacioneve të siguruara me ngjarjet aktuale dhe se si ato mund të ndikojnë në krijimin e një narrative të caktuar të dëmshme.

Më 7 korrik, më shumë se njëzetë media transmetuan për letrën e Komisioneres së Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Dunja Mijatoviç, Parlamentit të Maqedonisë, e cila inkurajon përpjekjet e vazhdueshme për miratimin e kuadrit ligjor në lidhje me njohjen ligjore të gjinisë në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës, kryesisht përmes miratimit të ndryshimeve në Ligjin për evidencën amë, si një hap thelbësor në ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Megjithatë, si në raportet e tjera gazetareske, postimi u përcoll dobët, duke cituar letrën dhe nuk u pasua nga një shpjegim shtesë, dhe disa nga mediat raportuan lajmin duke përdorur tituj sensacionalë, si **LGBT KOMUNITETI DO TË FITOJË MË SHUMË TË DREJTA NË MAQEDONI!? Mijatoviç i kërkon Talat Xhaferit, njohjen e njerëzve transgjitorë!**<sup>68</sup> Në të njëjtën ditë, disa media raportuan intervistën televizive të ministres Trençevska në të cilën ajo, ndër të tjera, foli për lëvizjet kundër konceptit gjinor, duke thënë se *gjithçka që u tha në publik ishte e pavërtetë, manipulim dhe injorancë, por në asnjë mënyrë thelbi i proceseve të dy*

67 Në dispozicion në: <https://nezavisen.mk/pendarovski-imame-informacii-deka-lugje-od-mpc-biznis-zaednicata-i-partiite-sorabotuvaat-so-ruski-sluzhbi/>

68 Në dispozicion në: <https://vocentar.com/%D0%BB%D0%B3%D0%B1%D1%82-%D0%B7%D0%B0%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B8%D1%86%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D1%9C%D0%B5-%D0%B4%D0%BE%D0%B1%D0%B8%D0%B5-%D0%BF%D0%BE%D0%B2%D0%B5%D1%9C%D0%B5-%D0%BF%D1%80%D0%B0%D0%B2%D0%B0/>

ligjeve, veçanërisht për barazinë gjinore, dhe se vendi ynë, dhe jo vetëm brenda rajonit, u njoh si një lider, i cili bëri shumë për barazinë gjinore.<sup>69</sup>

Brenda periudhës së analizuar, shfaqen raporte gazetareske që nuk i referohen kontekstit kombëtar, por promovojnë narrativën kundër gjinisë. Kështu, dhjetëra media publikojnë raporte në lidhje me një ligj të ri në Rusi që ndalon operacionet për “ndryshimin e seksit”, ku njerëzit me identitete të ndryshme gjinore nuk mund t’i nënshtrohen më procedurave kirurgjikale ose t’u përshkruhen hormone, duke e përcjellë lajmin përmes titujve të tillë si **Putini ndalon operacionet e ndryshimit të seksit: “Fëmijët po trajnohen se ka më shumë gjini.”**<sup>70</sup> Raportet citojnë deklarata të Putinit në të cilat ai thotë se në këtë mënyrë pengohen perversitetet që çojnë në degjenerim dhe zhdukje, që ju imponohen fëmijëve në shkollat tona që nga klasat e hershme.

Një pjesë shumë e vogël e raporteve gazetareske i konsiderojnë dy narrativat kontradiktore dhe në mënyrë kritike i qasen çështjes.<sup>71</sup> Shumica e raporteve reduktohen në transmetim të dobët të deklaratave dhe njoftimeve, ku më së shpeshti përfshihet vetëm njëra nga palët e interesuara. Megjithatë, edhe raportet që përfshijnë deklarata nga palët kundërshtarë nuk ofrojnë një rishikim kritik të tyre, as nuk hyjnë më thellë në përmbajtjen e tyre dhe nuk e rishqyrtojnë aspak rëndësinë e ekspertizës së personave të caktuar për çështjet që ata përpunojnë. Kështu, gazetarët përqendrohen në lajmet nga të cilat mund të riprodhohen titujt sensacionalistë.

69 Në dispozicion në: <https://kurir.mk/makedonija/vesti/trenchevska-za-tv24-nashata-drzhava-beshe-prepoznaena-kako-zemja-lider-koja-mnogu-napravi-za-rodovata-ednakvost/>

70 Në dispozicion në: <https://makfax.com.mk/svet/%D0%BF%D1%83%D1%82%D0%B8%D0%BD-%D0%B3%D0%B8-%D0%B7%D0%B0%D0%B1%D1%80%D0%B0%D0%BD%D0%B8-%D0%BE%D0%BF%D0%B5%D1%80%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B7%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%BE%D0%BC%D0%B5%D0%BD/>


71 Shihni më shumë në: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/crkvata-protestira-vlasta-veli-samo-se-debatira-shto-e-sporno-vo-zakonite-za-rod-/32478030.html>, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/oznaka-na-pol-mozhe-da-se-smeni-i-bez-noviot-zakon/32483696.html>, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/poglavarot-na-mpc--oa-g-g-stefan---zhenite-ne-sakaat-lazhna-ednakvost-i-lazhni-prava/32482611.html>, <https://360stepeni.mk/video-mpts-oa-kako-za-nishto-dosega-se-mobilizira-za-protest-protiv-predlog-zakonite-za-rodova-ednakvost-i-za-matichna-evidentsija/>



Burimi - Glasot na Amerika


Për të bërë një pasqyrë më të thellë të narrativës që del nga raportet gazetareske të publikuara, brenda këtij studimi u analizuan më shumë se 7,000 komente në postimet e tyre në rrjetin social Facebook. Analiza e komenteve tregon ekzistencën e një shkalle shqetësuese të gjuhës së urrejtjes drejtuar popullsisë LGBTI+, të treguar përmes komenteve të shumta fyese në të cilat ata quhen *satanistë, të shpifur, anormalë, patologji, sëmundje, të shtrembëruar, gabim i natyrës, imoral, etj.* Për më tepër, shumë komentues bëjnë thirrje për dhunë ndaj popullsisë LGBTI+, përmes zhdukjes së saj, përdorimit të dhomave të gazit, kastrimit dhe në disa raste glorifikimit të Hitlerit. Ajo që është domethënëse për kontekstin e kësaj analize është se pothuajse të gjitha komentet i drejtohen popullsisë LGBTI+, me fokus në “frikën” e legalizimit të martesës së të njëjtit seks, ku koncepti i barazisë gjinore, ndërsa me këtë edhe thelbi i ligjit, nuk diskutohet aspak. Në komente, më së shpeshti përdoret një narrativë “ne-normalët” kundrejt “të tjerëve-jo normalë”, brenda së cilës tjetri demonizohet dhe përfaqësohet si dikush që sulmon vlerat “e tyre” dhe “reale”. Në këtë rast, vlerat e tjetrit shpesh portretizohen si të imponuara nga Perëndimi dhe Evropa, përkatësisht BE-ja, dhe shihen si një e *keqe* që synon *shkatërrimin e familjes tradicionale*. Shumë nga këto komente vihen re në raportet gazetareske në lidhje me Paradën e Krenarisë, të plotësuara me komente të tilla si ku është *parada e turpit*, për çfarë jeni krenarë?, çfarë krenarie është kjo?. Në disa

nga komentet, mund të vërehet edhe promovimi i teorive të konspiracionit, si dhe identifikimi i popullatës LGBTI+ me pedofili.



**Translation:** po ama miratojnë ligj gej ideologji të zbatohet në çdo shtëpi...

Në Ligj thotë gruaja nuk guxon të lindë pa parae



**Translation:** a e di se nëse miratohet ky ligj, përpos tij imponohet edhe për pedofili nuk do të dënohet, por do të jetë përcaktim normal




**Translation:** të tillët duhen varur në mes të sheshit ja ashtu si në kohën e turkut vetëm kamxhiku për pederë të tillë dhe gej



**Translation:** Vetëm Hitleri përsëri të lindet as peder as lgbt nuk do ketë, pendla do të fluturojnë.


Publikimet e raporteve gazetareske që përcjellin deklaratat e ministres Trençevska janë një nga më të synuarat për prodhimin e komenteve me gjuhën e urrejtjes dhe dezinformimin gjinor që synojnë ministren. Përveç kësaj, shumë nga komentet përmbajnë fyerje të qarta për personalitetin, pamjen, kualifikime për ministren, spekulime në lidhje me orientimin seksual të ministrit të përdorur në kontekstin e fyerjes, si dhe komente me konotacion seksual, të cilat bëjnë thirrje për dhunë seksuale.




**Translation:** Dhe me këmbëngulje shtyhet agjenda e dikujt!! Me forcë jo normalja nuk mund të bëhet normale. A e dëgjoni zërin e popullit??

TI ERDHE TË NA TREGOSH, SHKO FSHIHU ATJE, JE PËR KEQARDHJE

Asgjë nuk pastrohet kjo agjendë koti. Ky prezantim farsë, i shtrembëruar dhe jo i plotë i turpit Gruaja është për Bardovci jo për ministrel!



**Translation:** Kjo derr njeri duhet të kryqëzohet në mes të Shkupit dhe gjithë familja e saj sepse është e dëmshme për popullin tonë, ajo duhet të operohet mos ketë organ as mashkullor, as femëror, ajo nga Zoti është e dënuar



**Translation:** Sa e shëmtuar është nuk ngjan në femër.


Është evidente që ministrja është në huti mendoja se ka tru po nuk paska.

Thua e di çfarë je? Unë besoj se nuk e di çfarë je dhe se je totalisht analfabet dhe person i pa edukuar, e emëruar si piun politik që ka humbur në kohë dhe hapësirë, për fat të keq kjo je ti në pika të shkurta.

Megjithatë, raportet gazetareske në lidhje me ministren Trençevska nuk janë të vetmet që hapin hapësirë për prodhimin dhe përhapjen e dezinformimit gjinor



dhe gjuhës së urrejtjes. Disa politikanë, pikëpamjet e të cilëve përcillen përmes raporteve gazetareske, të cilët shprehin mbështetje publike për ligjet duke publikuar pikëpamjet personale dhe partiake, marrin pjesë në diskutime publike, etj., bëhen objektiva të këtyre narrativeve negative. Kështu, për shembull, për deputetët Maja Moraçanin, Sanela Shkrielj, Snezhana Kaleska-Vançeva, përdoren fjalë fyese si *satanistë, të çmendura, të sëmura, shtriga*.



**Translation:** Ju jeni e sëmure në kokë

Kretene me banderolë



**Translation:** Jeni shërbyes të dreqit

Jeni më keq se shtrigat

Nuk mund tu shërbeni dy vetave. Ose do të jeni të dëgjueshëm ndaj Zotit ose do të kërkonit drejtësinë tuaj...Fali Zot, nuk dinë ç' bëjnë

A mendon çfarë flet

Për vjedhje edhe dreqin do ta votoni

Nuk mund të jesh në shërbim të Zotit dhe dreqit në të njëjtën kohë

Barazi gjinore është nëse gratë "nënat përdorin 2 vjet pushim të papaguar nga shteti për fëmijët e tyre

Jo shtriga vampirë jeni

You're not witches, you're vampires



**Translation:** Dhi, nuk ke as turp as namus, sortë e prishur

Dreqër të sëmurë dhe të shpifur

marsssss

Në sëmundje nuk ka barazi



**Translation:** I degjeneruar nuk është njeri

Turp me qëndrime të gabuara nga një intelektuale.

Qelbësirë.

Budallaçkë.

Përveç kësaj, postimet që përcjellin letrën e Komisioneres Mijatoviq bëhen shënjestër e fyerjeve dhe gjuhës së urrejtjes, ku në fokus është narrativa e *vlerave të imponuara të BE-së*. Dy profesorë akademikë që kritikojnë pozicionin e KOM-së gjithashtu bëhen shënjestër e komenteve të shumta fyese.

Evropski vrednosti. "Izopacenost na umot" i treba da sedime na ista masa.

Like Reply 10w

**Translation:** Vlera evropiane: "Çorodisje e mendjes" dhe duhet të ulemi në tryezë të njëjtë..

Укинувањето на традиционалното, природното семејство, на природните улоги на мажот и жената е основна вредност на ЕУ. Основната причина за постоењето на ЕУ требаше да биде обезбедување на мир и благосостојба, ама од тоа нема ништо, остана само уништувањето на се што е од Бога дадено. Народот треба да се реши, на две столице не може да се седи.

Like Reply 12w



**Translation:** Anulimi i tradicionales, familjes natyrore, roleve natyrore të burrit dhe gruas është vlerë e BE-së. Shkaku kryesor për ekzistimi e BE-së dihej të ishte sigurimi i paqes dhe mirëqenies, por nga kjo nuk ka gjë, ngeli vetëm shkatërrimi i çdo gjë që është falur nga Zoti. Populli duhet të vendosë, nuk mund të ulesh në dy karrige.

Disa nga komentet negative u drejtohen gjithashtu organizatave të caktuara të shoqërisë civile, kështu që, për shembull, thirrja për sigurinë e komunitetit LGBTI+ gjatë protestës pasohet nga komente të shumta negative. Megjithatë, aktivistët e shoqërisë civile bëhen gjithashtu një objektiv i drejtpërdrejtë i gjuhës së urrejtjes. Në një raport gazetaresk që transmetonte prezencën e një aktivisti civil në një shfaqje televizive ku diskutohen ligjet dhe nevojat e tyre dhe çfarë (nuk)përfshijnë, u vërejtën më shumë se 500 komente, pothuajse të gjitha kanë përmbajtje negative, përkatësisht komente me gjuhë urrejtjeje, nxitje për dhunë dhe fyerje.

ОВИЕ ВАКВИ САМО И САМО ВО ХАНГАР ЗА СТВАРАЊЕ НА НАЦИЈА СО БИОЛОШКО ГЕНЕТСКА НАЦИЈА ОД ГЕНЕТСКО СЕМЕ КАКО ХИТЛЕР ОВИЕ КАКО ОВАА ЛЕЗБЕЈКА И СИТЕ КАКО НЕЈА ПОД ХИТНО РЕШАВАЊЕ

Like Reply 11w




**Translation:** KËTA TË KËTILLËT VETËM NË HANGAR PËR TË KRIJUAR POPULL ME FARË GJENETIKE BIOLOGJIKE SI HITLERI, SI KJO LEZBIKE DHE TË GJITHË SI AJO URGJENTISHT TË ZGJIDHET



**Translation:** Mbrapa dhe ngadalë pa shpejtim.

GARUDO, MRSHSHSHS



**Translation:** Mos jepni as një minutë hapësirë për promovim të personave me çrregullime shpirtërore si kjo zonja në fjalë. Ajo është turp për vetveten dhe rrezik për shoqërinë.

Përmbajtja e komenteve që synojnë gratë në sferën publike që mbështesin miratimin e ligjeve, e cila në fakt barazohet me mbështetje për popullsinë LGBTI+, bazohet në stereotipet dhe paragjykimet gjinore dhe në kulturën e dhunës me bazë gjinore. Në këtë rast, nuk merret parasysh ekspertiza e tyre në këtë fushë, as nuk diskutohet thelbi i deklaratave të tyre, vetëm i referohet mbrojtjes së sistemit “tonë” të vlerave dhe dënimit dhe fyerjes për çdo gjë të ndryshme nga kjo. Përveç kësaj, megjithëse nuk ishin objekt analize brenda këtij studimi, është me rëndësi të veçantë të përmendet se një pjesë e mirë e grave të përmendura janë viktimat të gjuhës së urrejtjes dhe kërcënimeve që janë të dukshme nga llogaritë e tyre personale në mediat sociale. Ajo që duhet të merret parasysh është se shumë nga këto komente janë ende të dukshme për publikun.

# Diskutim përfundimtar

Ashtu si në dy analizat e mëparshme të përmbajtjes me bazë gjinore, mund të shohim se **përdorimi i gjuhës sensacionaliste, veçanërisht në titujt e raporteve gazetareske**, është përsëri i pranishëm në mënyrë të konsiderueshme. Duke pasur parasysh se audiencia në mediat sociale shumë shpesh i bazon komentet e saj pikërisht në tituj, dhe një pjesë nuk e lexon fare raportin gazetaresk, sensacionalizmi në tituj mund të ndikojë në nxjerrjen sipërfaqësore të përfundimeve nga lexuesit.

Kur bëhet fjalë për dezinformimin, nga analiza mund të shohim se **mediat nuk i përmbahen udhëzimeve për raportimin etik të online mediave**. Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e raporteve reduktohen në transmetim të dobët të deklaratave dhe njoftimeve, duke përfshirë më së shpeshti vetëm njërin nga palët kundërshtarë, mediat reduktohen vetëm në transmetues të “fakteve të servitura”. Raportet gazetareske nuk thellohen në përmbajtjen e deklaratave të transmetuara, ato nuk japin një rishikim kritik të tyre, është e qartë se **nuk bëhet verifikim i pretendimeve që transmetohen**. Në këtë mënyrë, **media nuk lejon që audiencia të bëjë dallimin midis fakteve dhe dezinformimit**. Për më tepër, raportet gazetareske **nuk e rishqyrtojnë aspak rëndësinë e ekspertizës së personave të caktuar për çështjet që ata trajtojnë**. Prandaj, kemi burra - klerikë që shesin gënjeshtër dhe argumente të pabaza në lidhje me kuptimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave dhe interpretimin e papërshtatshëm dhe selektiv të ligjeve, pa treguar nivelin e ekspertizës në këtë fushë.

Analiza e hapësirës mediatike që u është dhënë të dyja palëve tregon për një **përfaqësim joproporcional të gjerë të narrativave antigjinore në raportet gazetareske**, kryesisht përmes raportimit për mesazhet dhe aktivitetet e KOM-it dhe klerikëve të ndryshëm, përmes të cilave shpërndahen dezinformata të shumta. Në këtë mënyrë, mediat kontribuojnë drejtpërdrejt në forcimin e këtyre narrativave bazuar në perceptimet patriarkale regresive dhe stereotipet gjinore. Duke përforcuar stereotipet gjinore në hapësirën online, ajo ndikon drejtpërdrejt në përforcimin e qëndrimeve misogyniste për rolin e grave në sferën publike, duke kontribuar kështu në pabarazinë gjinore në shoqëri.

Duke lënë hapësirën mediatike për përhapjen e dezinformimit, **mediat gjithashtu kontribuojnë në përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe dhunës me bazë gjinore.** Në vend që të krijojnë përmbajtje me të cilat do t'i kundërvihen gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit mbi baza të ndryshme, media krijon terren pjellor për nxitjen e urrejtjes ose intolerancës, përfshirë në bazë të gjinisë, seksit, orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Analiza e përmbajtjes sugjeron për ndërgjegjësimin e ulët shoqëror të popullatës më të gjerë për këto çështje, si dhe qëndrimet patriarkale ende të rrënjosura thellë. Ajo që është veçanërisht shqetësuese është **numri alarmant i lartë i komenteve të gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI+, si dhe thirrjet për dhunë të qartë ndaj kësaj popullate.**

Duke lënë hapësirë për përhapjen e dezinformimit gjinor, **mediat kontribuojnë në dehumanizim dhe demonizim, si dhe sulme dhe kërcënime të drejtpërdrejta verbale ndaj mbështetësve të barazisë gjinore dhe komunitetit LGBTI+, shumica e të cilëve janë gra.** Si rezultat i dezinformimit gjinor, komentet në mediat sociale përdorin narrative që bazohen dhe përjetësojnë stereotipet gjinore, seksualizojnë gratë dhe bëjnë thirrje për dhunë seksuale. Këto përmbajtje mund të kenë pasoja serioze negative për praninë femërore në sferën publike, e cila është një nga qëllimet e lëvizjeve kundër gjinisë.

Duke marrë parasysh se kjo analizë u përgatit disa muaj pas ngjarjeve që ishin objekt i studimit, dhe u analizuan më shumë se 7.000 komente mbi raportet e lajmeve, mund të shohim se një pjesë e madhe e **mediave nuk kanë politikë të rregullimit të përmbajtjes së komenteve në postimet e tyre, përmes fshehjes ose fshirjes së përmbajtjeve me gjuhë urrejtjeje, fyerje dhe përmbajtje të tjera të dëmshme.** Duke marrë parasysh se përhapja e dezinformimit gjinor ndodh kryesisht përmes mediave sociale, me mungesë të rregullimit, mediat kontribuojnë në përhapjen e këtyre përmbajtjeve dhe mundësojnë mobilizimin e publikut për të mbështetur dhe krijuar më tej përmbajtje të re.

# Shënime përfundimtare

Nga analiza e kryer e përmbajtjes me bazë gjinore dhe argumentet e deklaruara në diskutimin përfundimtar, mund të nxjerrim disa gjetje kryesore në lidhje me dezinformimin gjinor në hapësirën mediatike online:

- Duke pasur parasysh përdorimin e shpeshtë të gjuhës sensacionaliste në titujt e lajmeve, gazetarët duhet të jenë të kujdesshëm në formulimin e titujve, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje të ndjeshme, pasi mund të ndikojë në nxjerrjen sipërfaqësore të konkluzioneve nga audienca;
- Mediat nuk i përmbahen udhëzimeve për raportimin etik të mediave online, përkatësisht nuk bëhet verifikimi i pretendimeve që përcillen, nuk bëhet rishikim kritik i deklaratave të përcjella, as nuk rivlerësohet rëndësia e ekspertizës. Në këtë mënyrë, media nuk lejon që audienca të bëjë dallimin midis fakteve dhe dezinformimit. Prandaj, është e nevojshme që media t'i përmbahet udhëzimeve të raportimit etik, duke verifikuar informacionin, përfshirjen e informacioneve shtesë në lidhje me pretendimet që transmetojnë, duke vënë në dukje dezinformimin si dhe shfaqjen e informacioneve në lidhje me kompetencën e deklaruësve për një çështje të caktuar. Mediat duhet të inkurajojnë gazetarinë hulumtuese dhe raportimin e bazuar në prova;
- Mediat mundësojnë një përfaqësim të gjerë në mënyrë disproporcionale të narrativeve kundër gjinisë në hapësirën mediatike, duke kontribuar kështu në lansimin dhe përhapjen e dezinformatave. Duke përforcuar stereotipet gjinore në hapësirën online, ajo ndikon drejtpërdrejt në përforcimin e stereotipeve gjinore dhe qëndrimeve misogyniste për rolin e grave në sferën publike, duke kontribuar kështu në pabarazinë gjinore në shoqëri. Mediat duhet të marrin parasysh hapësirën që ato lejojnë për narrative të bazuara në dezinformata, duke kryer verifikimin e brendshëm të fakteve që transmetohen, si dhe të punojnë në afrimin e burimeve të besueshme të informacionit të audienca përmes raporteve gazetareske;

- Analiza tregon ndikimin ende të fortë të stereotipeve gjinore në komunikimin e përditshëm në internet, i cili duhet të adresohet duke krijuar dhe ndarë përmbajtje që do të promovojë parimin e barazisë gjinore dhe përfitimet e zhvillimit të një shoqërie të barabartë gjinore;
- Është e nevojshme që media të krijojë përmbajtje që do të ndihmojnë audiencën të njohë vetë dezinformatat në hapësirën mediatike, informimin e saj për vetë fenomenin e krijimit dhe përhapjes së dezinformatave dhe dëmin që shkaktojnë;
- Përveç dezinformimit gjinor, mediat kontribuojnë në përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe dhunës me bazë gjinore. Në këtë kontekst, është e nevojshme mediat të fokusohen në krijimin e përmbajtjes që do të luftojë gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin për arsye të ndryshme, përfshirë në bazë të gjinisë, seksit, orientimit seksual dhe identitetit gjinor;
- Mediat nuk kanë politikë të rregullimit të përmbajtjes së komenteve në postimet e tyre, duke fshehur ose fshirë përmbajtje me dezinformata gjinore, gjuhë urrejtjeje, fyerje dhe përmbajtje të tjera të dëmshme. Në këtë drejtim, duhet të krijohen politika të brendshme dhe persona përgjegjës për rregullimin e komenteve me përmbajtje negative, në mënyrë që të parandalohet përhapja e mëtejshme e tyre.





Ky produkt është pregaditur në suaza të proektit “Përdorim i gazetarisë të themeluar ne fakte për ngritjen e vetëdijes dhe kundërshtimit të dezinformacioneve në hapësirat mediatike në Maqedoninë e Veriut “ i finansuar nga Qeveria e Mbretërisë së bashkuar me përkrahje e Ambasadës britaneze në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet të paraqitura në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë çdoherë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë britaneze.



Институт за  
комуникациски  
студии

